

V E N D I M
Nr.649, datë 20.11.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.203, DATË 3.5.1995 “PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME”

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 7 ndryshohet si vijon:

“Pagesa në lekë dhe bono privatizimi bëhet në çdo degë të Bankës Kombëtare Tregtare, kurse në lekë privatizimi bëhet në çdo degë të Bankës së Kursimeve për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit ose degëve të saj”.

2. Paragrafi i tretë i pikës 8 ndryshohet si vijon:

“Vendimi i komisionit të kthimit të pronave, i shoqëruar me kërkesën sipas pikës 6, shkronjat a,b,c, duhet të dorëzohet në degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit ose në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit detyrimisht deri para zhvillimit të ankandit. Në rast të kundërt ish-pronari i truallit e humbet të drejtën e parablerjes dhe i nënshtrohet ankandit”.

3. Paragrafi i parë i pikës 11 ndryshohet si vijon:

“Vendi dhe ora e saktë e fillimit të ankandit shpallet jo më vonë se 4 ditë nga afati i fundit i pranimit të kërkesave”.

4. Fjalët “Komisioni Përgatitor i Procesit të Privatizimit në Ministrinë e Financave” dhe “KPPP në Ministrinë e Financave” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Drejtoria e shoqërive publike në Ministrinë e Financave”, kurse fjalët “nënkomisioni përgatitor i privatizimit” dhe “nënkomisionet” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Degët e drejtorisë së shoqërive publike në Ministrinë e Financave”.

5. Referimet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994, ndryshohen dhe zëvendësohen me referime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.589, datë 16.10.1995.

6. Paragrafi i tretë i pikës 1, shkronja “d” e pikës 6, pikat 9 dhe 10, si dhe fjalët “bordit apo” në pikën 13, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi më datën 27.11.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi